



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë B e folur dhe e shkruar (3)

Ngarkesa: 4 kreditë, 40 seminare

Viti / Semestri: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse - Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim

Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore: Të zhvillojë kompetencat gjuhësore të studentëve në të folur dhe të shkruar në gjuhën ruse, përmes një progresioni të natyrshëm nga elementët bazë drejt teksteve më të pasura dhe komplekse. Të përforcojë përdorimin e gjuhës së folur dhe të shkruar në mënyrë të saktë dhe funksionale për situata reale komunikimi dhe për qëllime akademike. Të nxisë aftësinë e studentëve për të përpunuar dhe interpretuar informacionin gjuhësor dhe kulturor të lidhur me kontekstin rus. Të edukojë tek studentët mendimin kritik dhe aftësinë për të analizuar dhe sintetizuar informacionin në një gjuhë të huaj.

Objektivat specifikë lëndore:

1. Të përvetësojnë leksikun bazë dhe të avancuar, nëpërmjet analizës së teksteve të shkruara dhe audio.
2. Të zhvillojnë shprehjet në të folur dhe të shkruar përmes dialogëve, ushtrimeve laboratorike dhe lexim-interpretimit me intonacion të qartë.
3. Të kuptojnë dhe përdorin në mënyrë të integruar elementet leksiko-gramatikore dhe ato kulturore në kontekstin rus.
4. Të angazhohen në diskutime, përpunime të projekteve dhe punime që nxisin të menduarin analitik, kritik dhe krijues.
5. Të përdorin mjetet dixhitale për kërkime gjuhësore dhe kulturore si dhe të ushtrojnë përgjegjësi qytetare në ndërveprimet e tyre akademike dhe shoqërore.

Rezultate të pritshme:

1. Komunikojë në mënyrë të qartë në rusisht, me gojë dhe me shkrim, duke përdorur një fjalor të pasur dhe struktura gramatikore korrekte.
2. Lexojë, interpretojë dhe analizojë tekste të thjeshta dhe të ndërmjetme me përmbajtje kulturore ruse, duke evidentuar kuptimet leksiko-semantike dhe gramatikore.
3. Zhvillojë aftësi për të përshkruar dhe argumentuar ide, për të përpunuar informacion dhe për të marrë pjesë në diskutime mbi tema të përzgjedhura.